



NEWSLETTER

Maj 2025

Nr.5

Shënimi i 3 majit – Ditës Botërore të Lirisë së Mediave

Në kontekst të shënimit global të Ditës Botërore të Lirisë së Mediave, e cila këtë vit iu kushtua ndikimit të thellë të inteligjencës artificiale mbi gazetarinë dhe mediat, Agjencia më 3 maj përmes një njoftimi për shtyp, përkujtoi se vetëm mediat profesionale dhe të pavarura mund të kontribuojë për zhvillim të qëndrueshëm shoqëror dhe demokratik në epokën e ndryshimeve të shpejta teknologjike.

Në njoftim është theksuar se liria e medias nënkupton të drejtën e gazetarëve për të hulumtuar dhe informuar pa asnjë presion. Por me zhvillimin e inteligjencës artificiale, kjo liri merr kuptim të ri dhe përballet me sfida të reja. Inteligjenca artificiale hap mundësi të reja për avancim të gazetarisë investigative, automatizim të krijimit të përmbajtjeve dhe përshejtim të verifikimit të fakteve, por gjithashtu mbart dhe rreziqe të rëndësishme në aspektin e gjenerimit të dezinformatave, lajmeve të rreme dhe videove manipuluese.

Inteligjenca artificiale paraqet burim të vlefshëm në praktikën gazetareske, por nuk duhet të jetë zëvendësim i plotë për shqyrtim themelor, mendimin kritik dhe objektivitetin. Në këtë realitet të ri, është thelbësore që mediat me kujdes dhe përgjegjësi t'i përdorin këto mjete (vegla), duke iu përmbajtur standarteve më të larta etike dhe profesionale në punën e tyre.

Analizë për përcaktim të arsyeshmërisë për lehtësime tatimore për transmetuesit rajonal dhe lokalë

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale më 21 maj, publikoi analizën për përcaktimin e arsyeshmërisë për lehtësime tatimore për transmetuesit rajonal dhe lokalë, me qëllim për të përcaktuar se cilat masa për mbështetje janë të nevojshme që të impletohen për të nxitur zhvillim dhe për të forcuar qëndrueshmëri ekonomike të transmetuesve rajonalë dhe lokalë, duke u nisur para së gjithash nga roli i tyre kyç për sigurimin e pluralizmit ekonomik dhe zhvillim të proceseve demokratike në shoqëri.

Përpilimi i këtyre dokumenteve është parashikuar në Planin Strategjik të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, të cilat përfshijnë periudhën nga viti 2024 deri në vitin 2028.

Të dhënat për punën ekonomike të transmetuesve rajonalë dhe lokalë (të ardhurat në total, struktura e të ardhurave dhe rezultati financiar i realizuar nga puna në periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2023) të shfrytëzuara në analizë, janë siguruar nga vetë transmetuesit (në kuadër të përmbushjes së detyrimit nga neni 15 të Ligjit për Media, sipas të cilit janë të detyruar më së voni deri më 31-mars për çdo vit rregullatorit t'i dorëzojnë të dhëna, në formularë të veçantë të përcaktuar nga Agjencia), ndërsa validiteti i tyre verifikohet me të dhënat e llogarive përfundimtare të transmetuesve. Analiza mund të shkarkohet në [linkun](#) e mëposhtëm.

Debat publik për regjistrim në Regjistrin e botuesve të mediave online dhe mënyra e udhëheqjes së Regjistrit

Këshilli i Agjencisë në seancën e 19-të mbajtur më 8 maj, miratoi [Draft – Rregullore për formën dhe përmbajtjen e aplikimit për regjistrim në regjistrin e botuesve të mediave online-internet portaleve dhe për mënyrën e udhëheqjes së regjistrit të botuesve të mediave online-internet portaleve](#) dhe [Draft-Formular për dorëzim të të dhënave për transparencë të punës së botuesve të mediave online – internet portaleve](#). Për të dy dokumentet është hapur debat publik me kohëzgjatje prej 15 ditësh deri më 23 maj 2025.

Me ndryshimet dhe plotësimet e fundit të Ligjit për Media është paraparë evidenca e mediave online-internet portaleve në Regjistrin e botuesve të mediave online-internet portaleve, që do të udhëhiqet nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale si organ rregullator kompetent.

Regjistri i botuesve të mediave online-internet portaleve do të udhëhiqet në formë elektronike dhe do të përmbajë të dhëna themelore për botuesin e medias (emri dhe adresë të botuesit të medias, emri dhe mbiemri i personit përgjegjës, emri dhe adresë interneti të medias online dhe regjistruesi i domenit të internetit të maqedonisë.mk ose .mkd). Formulari përmban të dhëna për strukturën e pronësisë, redaksinë, të dhëna për punën ekonomike të vitit të kaluar dhe numrin e të punësuarve në media.

Agjencia ftoi të gjitha palët e interesuara, me mendimet dhe propozimet e tyre, të marrin pjesë në debatin publik dhe t'i dorëzojnë me shkrim në mënyrë elektronike në e-mail adresën contact@avmu.mk.



NEWSLETTER

Mbikëqyrja e transmetuesve, ORRPKE dhe ofruesve të ASHMA-së me kërkesë.

Mbikëqyrja e transmetuesve

Për më shumë detyrime ligjore – përdorimi i gjuhës në programe; transmetim ditor së paku 8 orë program televiziv; transmetim ditor së paku 30% program të ktijuar burimor si vepra audio ose audiovizuale maqedonase; respektim i rregullave gjatë transmetimit të komunikimit komercial audiovizual, mbrojtjen e të miturve nga programe që dëmtojnë zhvillim e tyre fizik, mendor ose moral; mbrojtjen e të dhënave personale të personave të mitur; sigurimin e kuizeve ose forma të tjera të pjesëmarrjes shpërblyese; shfrytëzimi i shërbimeve telefonike me vlerë të shtuar dhe votimi telefonik dhe transmetim i lojrave të fatit, mbikëqyrje e rregullt programore është kryer mbi TV Era, TV M, TV MTM, TV Shutel, TV Tera dhe TV Topestrada.

Nga mbikëqyrja është konstatuar se në programin e TV M dhe TV Tera më 2 maj, janë transmetuar programe me aplikim të gabuar të sinjalistikës paralajmëruese për program të kategorisë së dytë. Nga tërësia e pamjes së parashikuar të sinjalistikës paralajmëruese në fillim dhe gjatë kohës së transmetimit mungon numri „8“ dhe shenja „+“, si tregues të grupmohës së shikuesve për të cilën është destinuar programi.

Ndaj këtyre transmetuesve është kryer dhe mbikëqyrje e rregullt administrative për detyrimet për shpallje impresium, informacioni që duhet tu vihet në dispozicion përdoruesve dhe për detyrimin për shpallje të identifikimit të transmetuesit. Gjatë mbikëqyrjes nuk u konstatuan shkelje të detyrimeve administrative nga Ligji për Media dhe nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Ndaj të gjithë 90 transmetuesve është kryer mbikëqyrje e jashtëzakonshme administrative për të konstatuar nëse ndonjë transmetues ka kryer ndryshim të strukturës së pronësisë pa njoftim paraprak të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe pa miratim paraprak nga Agjencia. Mbikëqyrja rezultoi se të gjithë transmetuesit kanë vepruar sipas dispozitave ligjore.

ORRPKE

Agjencia ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore ndaj operatorët Skupi Kable, Kablekall dhe IP Sistems për detyrimin e paketës programore që e ritransmetojnë ku detyrimisht dhe papagesë të ofrojnë shërbimet programore të shërbimit publik radiodifuziv, si dhe për detyrimet për regjistrim të shërbimeve programore në Agjencion dhe titrimin e programeve që i ritransmetojnë. Nga mbikëqyrja nuk u konstatuan shkelje.

Ofruesit e ASHMA-së me kërkesë

Për detyrimet që i referohen transmetimit të veprave kinematografike dhe mbrojtjen e të miturve, është kryer mbikëqyrje e rregullt programore mbi ofruesit e ASHMA-së me kërkesë Telekom i Maqedonisë, Mtel, A1 Maqedoni dhe Svod Master. Nga mbikëqyrja nuk u konstatuan shkelje.

Masat e shqiptuara vërejtje publike

Këshilli i Agjencisë në seancën e 19-të mbajtur më 8 maj, ka shqiptuar masë vërejtje publike ndaj TV Due për shkak të mos publikimit impresium në disa programe të transmetuara më 25 mars 2025.

